



Komuna Lipjan

KONTRATA¹ & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS:

KONTRATA

E përpiluar më 21.05.2019

Komuna e Lipjanit përfaqësuar nga drejtori i prokurimit Adem Duriqi në vazhdim ("Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe

N.N "Nuha" nga Podujeva që e përfaqëson Nuhi Azemi Drejtor në vazhdim ("Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara më poshtë:

Titulli "Renovimi i maternitetit ne QKMF" me numër identifikues: 613 019 014 521

Neni 1 Lënda

Me fillimin e punëve do hapet ditari i punës dhe në terren duhet të jetë çdo herë inxhinieri i cili do ta nënshkruan ditarin së bashku me menaxherin e caktuar nga autoriteti kontraktues.

Plani dinamik perfshine 60 dite kalendarike nga hapja e ditarit të punës dhe çdo vonesë pa arsye më gjat se plani dinamik i ofertuar do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të zbatohen penalet.

Kontraktuesi do të dorzojë garancionin e punëve të kryera 10% të vleres së kontratës për 12 muaj para marrjes së pageses së fundit, nëse dështon në pagesën e garancionit të fundit nuk do ti kryhet pagesa

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi përgjithshëm i punëve është: **20,639.00€** apo shprehur me fjalë: njëzetëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë /euro / e zero /centë/.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai është i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Rishikimi dhe ndryshimi i çmimeve nuk pranohet dhe do te paguhet vetëm shuma e cekur ne nenin 2.1. Në rast se paraqiten pengesa të cilat duhet eliminuar patjetër për realizimin e projektit do të rregullohet me aneks kontratë

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

3.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

¹ Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

3.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës se vendit)

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për kontraktuesin

Emri:	Adem Duriqi	Emri:	Nuhi Azemi
Pozita:	Drejtor i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	21.05.2019	Data:	21.05.2019
Vula:		Vula:	

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "**Punë**" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrethim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "**Kontraktuesi**" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "**Menaxheri i Projektit**" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "**Çmimi Kontratës**" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "**Vendi i ndërtimit**" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "**Pajisjet e kontraktuesit**" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "**Skicat**" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "**KPK**" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "**KVK**" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve, të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguheshin ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njihet lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
- b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

Neni 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuase të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;

- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësura.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnojë Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rrisë detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti Kontraktues do të emërojë "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

9.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.3 Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuara, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

Neni 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të fillojë punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtojë dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 11 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do ti lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 12 Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere te nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përgjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigjojë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

Neni 13 Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës:

Neni 14 Paramasa dhe Parallogaria

14.1 Paramasa dhe parallogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe parallogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Parallogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në veçim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 15 Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

15.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

15.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Parallogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Parallogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

15.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 16 Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 17 Shkaqet për kompensim

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuara vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

Neni 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrës dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

Neni 20 Parapagimi

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 21 Mbajtja e Parasë

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shume në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kalojë periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

Neni 22 Siguria e ekzekutimit

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizojë Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 23 Kostoja e Riparimeve

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

Neni 24 Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftojë Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryejë të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshojë Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të japë instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

Neni 25 Llogaritja përfundimtare

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen t'i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshojë Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të

certifikoj cilëndo pagese finale e cila duhet ti paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren te meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do ti paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

Neni 26 Shkëputja e kontratës

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta lirojë vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 27 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë.

Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Neni 30 Forca madhore

30.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	8.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.
	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Inspektimi dhe testimi	9.1	Menaxheri i Projektit është: Idriz Kozhani <i>Nr tel</i> 044 118 897
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë : 3 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës prej 24.05.2019 dhe do të zgjatë deri 22.07.2019 ose 60 ditë kalendarike.
Plani dinamik		Plani dinamik nuk duhet të jetë më i gjatë se 60 ditë nga hapja e ditarit të punës dhe çdo vonesë pa arsye më gjat se plani dinamik i ofertuar do të konsiderohet shkelje e kontratës dhe do të zbatohen penalet
Përmirësimi i defekteve	13.1	Kontraktuesi do të dorëzojë garancionin e punëve të kryera 10% të vlerës së kontratës për 12 muaj para marrjes së pageses së fundit (pas pranimit teknik) e cila mund të jete në formë të sigurimit bankar apo kompani e licencuar e sigurimit dhe nëse dështon në pagesën e garancionit të fundit nuk do të kryhet pagesa .
Posedimi i vendpunimit	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë : 2 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.5 % e vlerës së kontratës/për ditë.

		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Parapagimi	20.1	Shuma e Parapagimit është: <i>S'ka parapagim</i>
Mënyra e pagesës		Pagesat do të bëhen: sipas situacioneve të përfunduara në teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrijnë shumën 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas pranimit teknik të punëve
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% e mjeteve do të mbahen deri në pranimin teknik, ndërsa pas pranimit teknik të punëve kontraktuesi do të sjellë sigurimin e garancionit të punëve në afat prej 12 muajve me të cilat do të përdoren për përmirësimin e defekteve nëse paraqiten gjatë kësaj kohe e kontraktuesi nuk përgjigjet
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është : 10 % e vlerës së kontratës apo 2,063.90 € e cila duhet të paguhet me rastin e nënshkrimit të kontratës në kohëzgjatje prej 90 ditëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve; është <i>[shëno përqindjen]</i> .
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	<i>Komisioni përbrenda Komunes, ose deri në instancë më të lartë që do të përbëhet nga drejtori i shërbimeve publike, drejtori i prokurimit dhe drejtori i Planifikimit dhe urbanizëm</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	<i>[shëno te dyja]</i> a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Ekonomike në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)]</i> .

RENOVIMI I MATERNITETIT NE QKMF

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin dhe montimin, lidhjet sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaritja e pozicioneve të bëhet sipas gjendjes së realizuar në teren. Në këtë projekt duhet të bëhet implementimi i materialeve efikente

A

MATERNITETI LIPJAN

1	Punët përgaditore	Njësia	Sasia	Çmimi(€)	Totali(€)
1	Sinjalizimi i punishtes (sipas standarteve të ndërtimit mbrenda dhe jashtë objektit) hyrje daljeve në kantier, duke përfshirë edhe montimin e tabelave informuese për siguri në punë.	Komplet	1.00	50.00	50.00
2	Përgaditja e punishtes, bartja e mjeteve dhe materialeve të nevojshme dhe të gjitha organizimet për fillimin e punimeve.	Komplet	1.00	50.00	50.00
				Shuma 1:	100.00€

2	Punët Renevuese	Njësia	Sasia	Çmimi(€)	Totali(€)
1	Grumbullimi dhe konzervimi i inventarit ekzistues, lëvizjet e tyre neper objekt, vendosjet duhet të bëhet në vendet ku e cakton organi mbikqyrës se bashku me perfaqesuesin e objektit , i tërë ky pozicion duhet të kryhet nën masa të rrepta dhe nën përcjellje të investitorit.	m ²	400.00	0.50	200.00
2	Të bëhet largimi me kujdes i shtresës finale të dyshemes nga lineliumi. Pozicioni përfshinë punët demoluese dhe bartjen materialit të demoluar në deponinë e përcaktuar nga organi mbikqyrës , largësia e deponisë maksimumi 5 km	m ²	350.00	0.50	175.00
3	Te bëhet demolimi me kujdes mbuleses se kulmit nga tjegullat, duke përfshi mveshjet dhe ulluqet horizontal dhe vertikal nga llamarina, Pozicioni përfshinë punët demoluese dhe bartjen e materialit të demoluar në deponinë e përcaktuar nga organi mbikqyrës. çmimi per m2 te siperfaqes se kulmit	m ²	400.00	0.50	200.00

4	Te behet demolimi komplet i rrjetit te rrufepritesit. Pozicioni përfshinë punët demoluese dhe bartjen e materialit të ne vendin e caktuar, ky material do te perdoret pas ri instalimit te rrufepritesit	komplet	1.00	100.00	100.00
5	Te behet demolimi me kujdes i keramikave dhe nenshtresave tjera ne dyshmet e banjove dhe koridoreve. Pozicioni përfshinë punët demoluese dhe bartjen materialit të demoluar në deponinë e përcaktuar nga organi mbikqyrës. largesia e deponise maksimumi 5 km	m ²	18.00	3.00	54.00
6	Te behet furnizimi dhe punimi dyshemes ne banjo dhe me pllaka te keramikes te kualitetit te larte, pozicioni perfshin ngjitesin, fugen dhe siperfaqen e pergaditur parprakishte.	m ²	18.00	15.00	270.00
7	Te behet furnizimi dhe punimi dyshemeve nga shtresa e epoksidit me nuance sipas perzgjedhjes se organit mbikqyres, ne qmim te kalkulohen edhe shtresa vetenivelizuese dhe kendoret adekuate	m ²	310.00	15.00	4,650.00
8	Te behet demolimi me kujdes i konstruksionit te kulmit ekzistues te objektit dhe vendosja e materialit ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, materiali i panevojshem largohet ne deponi.	m ²	410.00	0.30	123.00
9	Te behet furnizimi me material dhe suvatimi me te gjitha shtresat e nevojshme ne vendet e demtuara te suvatimit, ne pozicion te merret paraprakishte grryerja, pastrimi lysterja me baze dhe shtresat tjera suvatuese, siperfaqja duhet te jete e gatshme per ngjyrosje	m ²	120.00	2.80	336.00
10	Furnizimi, punimi dhe montimi i konstruksionit te tavanit me pllaka gipsi knauf ,perfshire edhe konstruksionin metalik . Tipi D112-A2 duke perfshire edhe lyrjen e tije.	m ²	400.00	6.50	2,600.00
11	Furnizmi dhe vendosja e foljes difuzive dhe dërrasave t=24 mm mbi konstruksionin kulmit, si bazament për vendosjen e letrës difuzive dhe listelave. Llogaria në m2 te projeksionit te pjerret	m ²	410.00	1.80	738.00
12	Furnizmi dhe vendosja e kontra listelave 2/4 cm në çdo 70cm mbi dyshemenë e dërrasave per krijimin e siperfaqes ajruese . Llogaria në m2 projeksioni i pjerret	m ²	410.00	0.50	205.00
13	Furnizmi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 80 cm mbi kontralistela . Llogaria në m2 projeksioni i pjerret	m ²	410.00	1.00	410.00

14	Furnizimi dhe vendosja e llamarines se plastifikuar dhe profiluar LV4 ne qmim te kalkulohet kulmaret, elementet lidhese bulonat si dhe te gjitha pjeset perxjellese	m ²	410.00	4.00	1,640.00
15	Furnizimi me material dhe punimi I mveshjeve te llamarines me gjeresi dhe forma te ndryshme zhviluese ne siperfaqen e kulmit dhe mveshjet e atikave mureve dhe elementeve tjera, ne qmim te kalkuohen te gjitha elementet lidhese, llogaria ne m2 te siperfaqes se llamarines se punuar.	m ²	105.00	5.00	525.00
16	Furnizimi me material dhe punimi I ulluqeve vertikal dhe horizontal nga llamarina e plastifikuar me te gjitha elementet tjera percjellese, llogaria per m'	m'	60.00	5.00	300.00
17	Te behet furnizimi me material dhe punimi i shtresave te gletimit ne tere siperfaqen e mureve dhe plafonit, pozicioni perfshin Furnizimi dhe lyerja me shtresen baze, furnizimin dhe rrafshimin me material te gatshem MP 75 sipas gjendjes se paraqitur, kendet e nevojshme metalike, si dhe dy shtresa glet me siperfaqe te lemuar e gatshme per ngjyrosje, parprakishte siperfaqja duhet te grryhet pastrohet dhe lyhet me baze ,dhe rrjeta komplet	m ²	1,350.00	0.80	1,080.00
18	Të bëhet furnizimi dhe ngjyrosja e mureve të brendshme në lartësi H=120 cm, me ngjyrë yndyrore dy shtresore, zonat e frekuentimit në korridore dhe dhoma me dizajn dhe kërkesa sipas organit mbikqyrës, materiali duhet te jetë EKO.	m ²	400.00	0.80	320.00
19	Të bëhet furnizimi dhe ngjyrosja e mureve dhe plafoneve me ngjyrë polikolor në dy shtresa sipas ISO standardeve EKO me nuancë të bardhë.	m ²	350.00	0.50	175.00
20	Furnizimi dhe montimi I termoizolimit neper mure, ne llogari te merret stiropori N4 5 cm, rrjetë rabric, llaq I plastifikuar, ngjyra dhe te gjitha elementet per kryerjen e plote te ketij pozicioni	m ²	80.00	8.00	640.00
21	Te behet furnizimi dhe rregullimi I mekanizmave per hapje dhe mbyllje te dritareve dhe gomat, llogaria ne cope ,	copë	20.00	15.00	300.00
22	Te behet furnizimi dhe rregullimi I mekanizmave per hapje dhe mbyllje te te dyerve bravave dhe cilindrat llogaria ne cope	copë	10.00	10.00	100.00

	Te behet furnizimi me material dhe punimi i gypit te ujesjellesit Ø32 per lidhjen e objektit deri ne vendin e caktuar nga organi mbikqyes, ne llogari te merret hapja e kanalit H=80cm, vendosja e reres perreth gypit dhe mbyllja e kanalit, furnizimi dhe montimi i pjeseve fazonike	m'	80.00	6.50	520.00
23	,ventilat mbylles ,ventili jo kthyes ,ujematesi me pusete me dimensione 120x120x100cm me kapakun nga materiali nga kompoziti dhe te betonohet korniza e tij , ne qmim te llogariten te gjitha punet tjera paraprake per realizimin e keti pozicioni, qmimi ne m' te kanalit				
24	Te behet furnizimi me material dhe punimi i kanalizimit per lidhjen e objektit deri ne vendin e caktuar nga organi mbikqyes, ne llogari te merret hapja dhe mbyllja e kanalit, furnizimi dhe montimi i gypave te brinjezuar Ø200 me gjatesi l=60 m ,mbushja me rere perreth gypit, ne qmim te llogariten te gjitha punet tjera paraprake per realizimin e keti pozicioni, qmimi ne m' te kanalit\	m'	60.00	5.00	300.00
25	Te behet furnizimi dhe montimi i pusetave nga betoni me diameter Ø800mm ne pozicion te llogaritet konusi kapaku metalik me aftesi mbajttese deri ne 20T dhe betonimi i kornizes thellesia e pusetes 1.5 deri ne 2 m	copë	4.00	150.00	600.00
26	Te behet furnizimi me material dhe montimi i lavamanave komplet me paisjet perxjellese ne ordianca, pozicioni perfshin frunzimi dhe intsalimin e gypit te ujesjellesit nga pika me afert e marrjes se ujit deri te lavamani, furnizimin dhe punimin e kanalizimit per lavamanat deri ne piken me tafert te shkarkimit, punet e theyrjes se murit dhe dyshmes per vendosjen e gypit te ujesjelleit dhe kanalizimi, permisimin e tyre pas vendosjes se gypavem, qmimi per kompelt lavamin deri ne fuknsion te plote.Ne kete pozicion duhet te perfshihet edhe nderrimi i gypit te mesingut ne gyp plastike PVC Ø50 deri jashte pusetes se objektit	copë	16.00	60.00	960.00
27	Te behet furnizimi dhe montimi i ek-vintlave ne qmim te llogariten te gjitha punet tjera paraprake per realizimin e keti pozicioni.	copë	38.00	5.00	190.00
28	Te behet furnizimi dhe montimi i rubineta per lavanm me ujet te ftohet dhe te ngrohete ne qmim te llogariten te gjitha punet tjera paraprake per realizimin e keti pozicioni.	copë	16.00	18.00	288.00

29	Te behet furnizimi dhe montimi I bojlerit 120 L ne qmim te llogariten te gjitha punet tjera paraprake per realizimin e keti pozicioni.	copë	1.00	150.00	150.00
30	Te behet furnizimi dhe montimi i të WC-së se rrafshet (turke) komplet (kazani, gypi, bateritë, etj)	copë	2.00	80.00	160.00
31	Te behet rivitalizimi i rrejtit elektrik komplet objektit , duke llogaritur furnizimin me material te nevojshem fida, siguresa dhe elemente tjera perxjellese	copë	1.00	100.00	100.00
32	Të bëhet funizimi dhe montimi i prizave elektrikw dy fazore.	copë	50.00	5.00	250.00
33	Të bëhet funizimi dhe montimi i nderpreseve elektrik.	copë	15.00	5.00	75.00
34	Të bëhet funizimi dhe montimi i prizave elektrik tri fazore,	copë	5.00	10.00	50.00
35	Të bëhet funizimi dhe montimi i dritav LED me gjatesi 1.2 m Parprakishte te largohen ekzistueset, pozicioni perfshin edhe elementet tjera perxjellese	copë	40.00	18.00	720.00
36	Të bëhet funizimi dhe montimi i dritave me senzore me te gjitha elementet perxjellese ne vendet e caktura.	copë	3.00	20.00	60.00
37	Të bëhet funizimi dhe montimi reflektoreve me te gjitha elementet perxjellese ne vendet e caktura.	copë	3.00	25.00	75.00
38	Të behet furnizimi dhe montimi I sistemit te interfonave ne objekt, pozicioni perfshin kabblimin centalen dhe paisjet tjera.	copë	1.00	100.00	100.00
39	Të bëhet pastrimi dhe riparimi I radiatorve ndrrimi I elementeve lidhese kontrollimi per rrjedhje, radiatoret duhet te jen te gatshem per funksion.	copë	10.00	25.00	250.00
40	Furnizimi mem material dhe punimi I sistemit te rrufepritesi per komplet objéktin ne qmim te kalkulohen elementet lidhese, kutija matese, 50 m shirit rrufepritesi deh 4 sonda, pozicioni perfshin te ghitha elementet perxjellese	komplet	1.00	150.00	150.00
41	Furnizimi dhe montimi I deres hyrese nga plastika PVC profili 9cm duke perfshire mekanizmin hidraulik .Me dimensione 160x200cm	cope	1.00	400.00	400.00
				Shuma 2:	20,539.00€

Vërejtje: Punëkryesi duhet ti paraqesë menaxherit të projektit mostrat për materialet që kërkohen me karakteristikat për çdo material dhe nuk ka të drejtë të aplikojë materiale pa aprovimin e mostrës nga organi mbikqyrës si dhe t'i siguroj atestet dhe të bëjë shqyrtimet e funksionimit të elementeve.

RIKAPITULLIMI I PUNEVE

1	Punët përgaditore	100.00€
2	Punët Renevuese	20,539.00€
	TOTALI ME TVSH	20,639.00€